

VENDIM
Nr. 8/2017

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT “PËR HETIMIN DHE VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT NË FUQI, MBROJTJEN E INTERESIT TË SHTETIT SHQIPTAR GJATË PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES, NEGOCIMIT TË MARRËVESHJES SË SHITJES SË AKSIONEVE, MIRATUAR ME LIGJIN NR. 10 116, DATË 23.4.2009, “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHITJES SË 76 PËR QIND TË AKSIONEVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SHA NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE CEZ A.S”, SI DHE EVIDENTIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË SHKAKTUARA NGA NDJEKJA E ZBATIMIT TË KËSAJ MARRËVESHJEJE”, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 30/2016

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78, të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit hetimor,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin dhe verifikimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi, mbrojtjen e interesit të shtetit shqiptar gjatë procedurave të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, negocimit të marrëveshjes së shitjes së aksioneve, miratuar me ligjin nr. 10 116, datë 23.4.2009, “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ A.S.-së”, si dhe evidentimin e efekteve negative financiare të shkaktuara nga ndjekja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 30/2016, zgjatet deri në datën 22 mars 2017.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 2.2.2017